

Vendim nr. 163, datë 22.05.2026

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Marsida Xhaferllari, Kryesuese
Genti Ibrahim, Anëtar
Ilir Toska, Anëtar

në datën 22.05.2026 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 1 (Xh) 2026 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **XHELAL KRASNIQI**, përfaqësuar nga avokati Alban Qafa, me prokurë.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 107, datë 05.12.2025 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, pika 1, 33, pika 1, 42, pika 2, dhe 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6, pika 1, i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 27 dhe 71/a, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Ilir Toska, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese të saj, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Mbi referimin e Njesisë për Hetimin e Narkotikëve dhe Trafiqueve, pranë drejtorisë hetimore të departamentit të Policisë së Shtetit, për të dhëna lidhur me disa shtetas shqiptarë që dyshohej se ishin përfshirë në aktivitetin kriminal të dhënies së ndihmës për kalim të paligjshëm të kufijve, nëpërmjet falsifikimit të dokumenteve të udhëtimit, Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (*Prokuroria e Posaçme*), në datën 12.10.2022, ka regjistruar procedimin penal nr. 177, për veprat penale “Ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve”, më shumë se një herë, të kryer në formën e bashkëpunimit të veçantë; “Falsifikimi i dokumenteve të identifikimit”, të kryer në formën e bashkëpunimit të veçantë; “Grupi i strukturuar kriminal”, “Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale apo grupi kriminal”, të parashikuara nga nenet 298, 189, 333/a dhe 334, pika 1, të Kodit Penal (*KP*).

2. Në kuadër të këtij procedimi penal është krijuar skuadra e përbashkët hetimore me autoritetet gjyqësore të Tarragonës, Spanjë, dhe është shkëmbyer informacion me agjenci të ndryshme të huaja ligjzbatuese. Përmes metodave speciale të hetimit dhe veprimeve simuluese, përfshirë blerjen e dokumenteve të falsifikuara, është dokumentuar mënyra e veprimit të grupit kriminal që nga ndërmjetësimi, udhëzimi për udhëtimin, transportimi, pritja dhe takimet në Spanjë me persona të grupit kriminal, dhënia e dokumenteve të falsifikuara dhe udhëzimi për mënyrën e udhëtimit, deri te vëzhgimi në aeroportin nga ku do të udhëtonin. Nga tërësia e veprimeve hetimore ka rezultuar se drejtuesi i grupit kriminal është shtetasi B.S., i cili drejton dhe ka lidhje me të gjithë të pandehurit e tjerë të përfshirë, që nga prodhimi i dokumenteve të falsifikuara, deri te mbërritja në Mbretërinë e Bashkuar, nëpërmjet Irlandës së Veriut. Po kështu, ka rezultuar nga hetimi se dokumentet e falsifikuara janë kryesisht pasaporta sllovene, italiane, rumune etj., prodhimi i të cilave kryhet në Kosovë dhe në Shqipëri dhe se kërkuesi dhe i pandehuri tjetër F.R., me shtetësi kosovare sigurojnë pasaportat e falsifikuara.

3. Në datën 04.06.2025, pas përfundimit të hetimeve, Prokuroria e Posaçme ka paraqitur në gjykatë kërkesë për dërgimin në gjyq të procedimit penal ndaj disa të pandehurve, mes të cilëve edhe kërkuesi Xhelal Krasniqi, i akuzuar për kryerjen e veprave penale “Ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve”, të kryer në formën e bashkëpunimit të veçantë për qëllime përfitimi, “Falsifikimi i letërnjoftimeve, pasaportave ose vizave”, të kryer në formën e bashkëpunimit të veçantë, “Grupi i strukturuar kriminal”, të kryer në formën e pjesëmarrjes dhe “Kryerja e veprave

penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal”, të parashikuara nga nenet 298, pika 2 e 28, pika 4, 189, pika 1 e 28, pika 4, 333/a, pika 2 dhe 334, pika 1, të KP-së.

4. Gjatë shqyrtimit të kërkesës në seancë paraprake në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (*GJKKO-ja e Shkallës së Parë*) kërkuesi, nëpërmjet mbrojtësit të tij, ka kërkuar pavlefshmërinë e kërkesës së prokurorit për dërgimin e çështjes për gjyq, si dhe gjykimin e shkurtuar.

5. Me vendimin nr. 107, datë 05.12.2025, gjyqtari i seancës paraprake në GJKKO-në e Shkallës së Parë ka vendosur dërgimin për gjykim të procedimit penal nr. 177 të vitit 2022 të Prokurorisë së Posaçme. Sipas asaj gjykate, duke iu referuar fakteve penale, për të cilat akuzohen kërkuesi dhe të pandehurit e tjerë, hetimet e kryera nga Prokuroria e Posaçme rezultojnë të plota në kuptim të nenit 332/ç, pika 1, të Kodit të Procedurës Penale (*KPP*). Në këtë drejtim, ajo gjykatë ka mbajtur në konsideratë se, në lidhje me këto fakte, është administruar dokumentacioni përkatës; janë pyetur personat që kanë dijeni për veprën penale ose dyshoheshin për kryerjen e saj; janë administruar të dhëna të marra me letërporosi, të nevojshme për hetimin; janë marrë dhe administruar komunikimet elektronike të zhvilluara mes personave të përfshirë; është kryer ekzaminimi i sendeve të sekuestruara për llogari të procedimit penal. Për këtë arsye, ajo ka vlerësuar se nuk ka vend për kthimin e çështjes për plotësimin e hetimeve. Gjithashtu, GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka mbajtur në konsideratë edhe faktin se mbrojtësit dhe të pandehurit nuk kanë kërkuar marrjen e ndonjë prove të re, ose kryerjen e hetimeve shtesë dhe se kohëzgjatja disavjeçare e procedimit ka qenë e mjaftueshme që organi i hetimit të kryente çdo veprim hetimor që e kishte vlerësuar të nevojshëm. Në lidhje me ekzistencën dhe kualifikimin ligjor të faktit penal që u atribuohet të pandehurve, GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka vlerësuar se, në aspektin sasior, Prokuroria e Posaçme ka marrë provat e nevojshme për të mbështetur akuzën, ndërsa në aspektin përmbajtësor këto prova japin të dhëna që përmbushin standardin e mjaftueshmërisë. Po kështu, ajo ka vlerësuar se nuk rezultonte në mënyrë evidente prania e ndonjërit prej shkaqeve ligjore për pushimin e procedimit penal.

6. Në datën 19.03.2026 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij.

II

Pretendimet e kërkuesit

7. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar cenimin e *së drejtës për proces të rregullt* në drejtim të:

7.1. *Së drejtës për t'u dëgjuar*, pasi kërkuesi nuk është marrë në pyetje pas përfundimit të hetimeve edhe pse e ka kërkuar shprehimisht atë. Për rrjedhojë, në kuptim të nenit 331, pika 2, të KPP-së, kërkesa për dërgimin e çështjes në gjyq është e pavlefshme për sa kohë nuk janë respektuar parashikimet e nenit 327, pika 4, të KPP-së, që përcakton detyrimin për pyetjen e të pandehurit kur kërkohet prej tij. Gjykata ka disponuar njëlloj si prokuroria, ndërkohë që në përputhje me funksionin e saj ajo duhej të kontrollonte ligjshmërinë e kërkesës për gjykim dhe respektimin e të drejtave procedurale, pra duhet të konstatonte dhe të shpallte pavlefshmërinë e kërkesës për gjykim dhe t'ia kthente çështjen prokurorit. Gjykata nuk e ka shqyrtuar kërkesën e kërkuesit për pavlefshmërinë e kërkesës së prokurorit dhe nuk është shprehur për të në dispozitiv, por ka vendosur kalimin e çështjes për gjykim të shkurtuar, duke cenuar në këtë mënyrë edhe parimin e *sigurisë juridike*.

7.2. *Së drejtës për gjykim të drejtë*, pasi gjykata, duke mos marrë parasysh kërkesën e kërkuesit për shpalljen e pavlefshmërisë së kërkesës së prokurorit për gjykim, ka kaluar kufijtë të vendosura nga neni 331, pika 2, i KPP-së. Gjykata duhej të konstatonte dhe të shpallte pavlefshmërinë e kërkesës për gjykim dhe t'ia kthente çështjen prokurorisë. Në këtë mënyrë është cenuar edhe *e drejta për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur*, si dhe *e drejta e aksesit*.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkuesit

8. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f”, dhe 134, pikat 1, shkronja “i”, dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private ose publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me

afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, shterimin e mjeteve juridike, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

9. Kriteret paraprake të legjitimitimit janë të natyrës kumulative, ndaj, në këtë këndvështrim, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për shqyrtimin e ankimit kushtetues individual. Mbi këtë bazë, Kolegji, në vijim, do të ndalet në një prej kriterëve të legjitimitimit, konkretisht në atë të *shterimit të mjeteve juridike efektive*.

10. Për sa i përket kriterit të *shterimit të mjeteve juridike efektive*, individi mund t'i drejtohet Gjykatës me ankim kushtetues individual, vetëm pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që ai pretendon se i janë cenuar. Detyrimin për përmbushjen e këtij kriteri Gjykata e ka vlerësuar si në rastet e vendimeve përfundimtare, që kanë përmbyllur në themel procesin gjyqësor, ashtu edhe në rastin e vendimeve të ndërmjetme, karakteri i të cilave është konsideruar përfundimtar për qëllimet e nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës. Gjykata ka pohuar se në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, mbrojtja kushtetuese ka një funksion subsidiar, që do të thotë se ajo mund të kërkohet vetëm për një vendim përfundimtar, të çfarëdolloj forme, që përmbyll procesin gjyqësor, pasi individi ka shteruar mjetet dhe rrugët e tjera ligjore (*shih vendimet nr. 29, datë 16.04.2024; nr. 18, datë 19.03.2024; nr. 38, datë 02.12.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Ky kriter përbën parakusht që duhet përmbushur nga kërkuesi, i cili, përpara se t'i drejtohet Gjykatës, duhet të vërtetojë se i ka përdorur të gjitha mjetet ligjore të njohura nga ligji dhe të mjaftueshme për të rivendosur të drejtat e shkelura. Mjetet ligjore shterojnë kur në varësi të rrethanave të çështjes rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi (*shih vendimin nr. 10, datë 04.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Qëllimi i kësaj dispozite kushtetuese është, ndër të tjera, të mundësojë, brenda sistemit gjyqësor të zakonshëm, parandalimin ose riparimin e shkeljeve të pretenduara, përpara se të tilla pretendime të paraqiten në Gjykatë (*shih vendimet nr. 14, datë 11.03.2021; nr. 29, datë 30.03.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Megjithatë, Kolegji vëren se në juridiksionin kushtetues janë përfshirë, në mënyrë përjashtimore, edhe vendimet gjyqësore të ndërmjetme, kur plotësohen këto kushte: (i) shkelja e pretenduar është pasojë e drejtpërdrejtë e vendimit të ndërmjetëm të kundërshtuar, pra provohet se kërkuesi është viktimë e shkeljes të së drejtës kushtetuese; (ii) vendimi është bërë objekt i ankimit të veçantë dhe është shqyrtuar nga gjykatat më të larta, të cilat të jenë shprehur, qoftë edhe

tërthorazi, për të drejtën që pretendohet e cenuar; (iii) vendimi ka një masë autonomie nga procesi i themelit, në kuptimin që pavarësisht se shqyrtimi i mosmarrëveshjes së themelit vazhdon, vendimi përfundimtar nuk është i aftë të ndryshojë vendimin e ndërmjetëm dhe as të riparojë në masën e duhur efektet që ai ka sjellë (*shih vendimet nr. 25, datë 13.10.2022; nr. 14, datë 11.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Të tilla janë edhe vendimet për caktimin ose zëvendësimin e masave të sigurimit personal (*shih vendimet nr. 81, datë 21.11.2024; nr. 19, datë 21.03.2024; nr. 17, datë 13.03.2024 të Gjykatës Kushtetuese*), ose ato për sekuestrimin e pasurive gjatë procedimit penal (*shih vendimet nr. 79, datë 12.11.2024; nr. 18, datë 19.03.2024; nr. 14, datë 11.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Përfshirja e këtyre vendimeve në kontrollin kushtetues është pranuar për shkak të pasojave që ato sjellin në të drejtat themelore të individit. Kjo lidhet me faktin se këto vendime kanë autonomi në raport me procesin gjyqësor të themelit, ku përcaktohet (pa)fajësia e personit dhe se cenimi i pretenduar i të drejtave substanciale buron drejtpërdrejt prej tyre.

13. Kolegji vëren se objekt i ankimit kushtetues individual në shqyrtim është vendimi i GJKKO-së së Shkallës së Parë që ka pranuar kërkesën e Prokurorisë së Posaçme për dërgimin në gjyq të çështjes penale në ngarkim edhe të kërkuarit, pra një vendim që i hap rrugë shqyrtimit të akuzës në themel, por që nuk e përmbyll procesin penal ndaj tij. Ky vendim nuk përcakton në mënyrë përfundimtare (pa)fajësinë e kërkuarit për kryerjen e veprave penale për të cilat ai është akuzuar dhe, për nga natyra e tij, nuk sjell një pasojë të drejtpërdrejtë, të menjëhershme dhe të riparueshme në të drejtat themelore të tij. Kolegji konstaton se pretendimet e kërkuarit lidhen me vlefshmërinë e kërkesës së prokurorit për dërgimin e çështjes në gjyq, me mosmarrjen e tij në pyetje pas përfundimit të hetimeve dhe me mënyrën sesi gjykata e seancës paraprake ka ushtruar kontrollin për kërkesën e prokurorit. Këto pretendime, për nga natyra e tyre, janë pretendime procedurale që mund të paraqiten, shqyrtohen dhe, nëse është rasti, të riparohen gjatë gjykimit të çështjes në themel dhe përmes mjeteve të ankimit të parashikuara nga ligji. Kërkuari, personalisht ose nëpërmjet mbrojtësit të tij, ka mundësinë të parashtrojë pretendimet lidhur me akuzën, të kërkojë marrjen e provave që i konsideron të nevojshme, të kundërshtojë provat dhe pretendimet e akuzës, si dhe të përdorë mjetet e ankimit ndaj vendimmarrjeve gjyqësore që do të jepen në vijim, përfshirë, pas shterimit të tyre, edhe mbrojtjen kushtetuese në këtë Gjykatë.

14. Për sa më sipër, në kushtet kur vendimi objekt kundërshtimi nuk konsiderohet përfundimtar për qëllime të gjykimit kushtetues, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të

Kushtetutës, Kolegji vlerëson se nuk plotësohet kriteri i shterimit të mjeteve juridike në dispozicion, për rrjedhojë ankimi kushtetues individual i paraqitur nga kërkuesi nuk mund të merret në shqyrtim.

15. Në përfundim, Kolegji çmon se ankimi kushtetues individual i kërkuesit nuk plotëson kriteret ligjore paraprake për kalimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “d”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.